

ASTARE



BETON PRIMER

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E kuqerremtë	Kovë, 5, 10, 20 Kg	4-5 m ² /litër

PËRSHKRIM

Shtresë lidhëse që përdoret për trajtimin e sipërfaqeve të lëmuara të betonit për brenda dhe jashtë.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

- Është material i lëngshëm me bazë rrëshire akrilike, që përdoret për trajtimin e sipërfaqeve të lëmuara të betonit.
- Siguron një lidhje shumë të mirë midis betonit dhe shtresave mbushëse si llaç, stuko, hidroizolues, etj.
- Përdorimi i këtij materiali eliminon nevojën e përdorimit të sprucos së çimentos në sipërfaqe të lëmuara të betonit.
- Trajtimi i sipërfaqeve me BETON PRIMER siguron një punueshmëri mjaft të mirë si dhe lehtësi të dukshme në aplikimin e shtresave të tjera.
- Uniformizon shkallën e absorbueshmërisë së sipërfaqes ku do të aplikohet.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për trajtimin e sipërfaqeve të lëmuara të betonit, të cilat më pas do të mbushen me llaç mbushës, fino, etj. Përdoret si izolues, fiksues i sipërfaqeve që më pas do të lyhen ose do të vishen me shtresa të tjera si llaç, fino, etj.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti ku do të aplikohet BETON PRIMER paraprakisht duhet të jetë i thatë dhe i pastër nga pluhurat si dhe nga mbetjet e naftës, verniqeve, dyllit apo materialet kundër ngjitjes. Pastrimi i suportit bëhet në mënyrë manuale ose mekanike.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Produkti duhet përzier në kovë në mënyrë manuale dhe pas kësaj është i gatshëm për përdorim. Nëse është e nevojshme, produkti mund të hollohet deri në 20% me ujë.

APLIKIMI

Produkti aplikohet me furçë ose me rul në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Duhet pritur të paktën 12-24 orë që BETON PRIMER të thahet në varësi të temperaturës përpara se të aplikohet produkti pasardhës mbi suport. Temperaturat e ulëta si dhe prania e lagështirës rrisin ndjeshëm kohën e tharjes. Nuk duhet të aplikohet kur suporti ka temperaturë më të ulët se +5°C dhe duhet të sigurohemi që deri në 24 orë pas aplikimit nuk do të laget.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Lëng	Konsumi: 4-5 m²/kg
Paketimi: Kovë plastike 5, 10, 20 kg	Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Ngjyra: E kuqerremtë	Koha e magazinimit: 24 muaj nga data e prodhimit
Djegshmëria: I padjegshëm	

